



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Radio Kosovska Mitrovica
Caslav Milisavljevic
Drejtor
Zvecan

Ankesa Nr. 2014/ 183 vs Radio Kosovska Mitrovica
Ref: 1409/1034/KPM/a.z

VENDIM

Lidhur me Ankesën nr. 2014/183 – Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) kundër Radio Kosovska Mitrovica (“Palë Përgjegjëse”)

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) me datën 6 tetor 2009, ka vendosur që Palës Përgjegjëse t'i lëshoj licencë për transmetim si radio lokale në Komunën e Zveçanit.
2. KPM është vënë në dijeni që pronari i Palës Përgjegjëse ka filluar aktivitete politike duke u zgjedhur anëtar i Kuvendit Komunal të Komunës së Zveçanit duke u përfshier kështu aktivisht në politikë, veprim ky i cili bie në kundërshtim me nenin 22, paragrafi 3.1, të Ligjit të KPM-së dhe me nenin 9, paragrafi 1.2, të Rregullores KPM- 2013/04.
3. KPM, bazuar në shkeljen e Ligjit të KPM-së dhe të Rregullorës KPM-2013/04, nga ana e Palës Përgjegjëse, me datën 21 mars 2014, i ka dërguar Urdhër Palës Përgjegjëse për shkeljet e bëra dhe ka kërkuar që menjëherë Pala Përgjegjëse të vie në pajtueshmëri.
4. KPM, pas dërgimit të Urdhrit, me datën 28 mars 2014 përmes e-mailit ka pranuar një përgjigje nga Pala Përgjegjëse e cila mohon faktin se është përfshier në ndonjë aktivitet politik.
5. KPM, me qëllim të verifikimit nëse Pala Përgjegjëse është përfshier në politikë, me datën 27 qershor 2014 ka bërë kërkesë edhe në Ministrinë e Pushtetit Lokal për të vërtetuar nëse z. Caslav Milisavljevic, Pala Përgjegjëse, është zgjedhur anëtar i Kuvendit Komunal të Komunës së Zveçanit.
6. Me datë 2 korrik 2014, KPM ka pranuar informatë zyrtare nga Ministria e Pushtetit Lokal se z. Caslav Milisavljevic, Pala Përgjegjëse, është zgjedhur anëtar i Kuvendit Komunal të

Komisioni i Pavarur i Mediave/Nezavisna Komisija za Medije/Independent Media Commission, Rr.Ul.Str. Perandori Justinian Nr. 14 Qyteza, Pejton, 10000 Prishtinë-Priştin- Pristina/Kosovë-Kosovo, Tel: (+381) (0) 38 245 031, Fax: (+381) (0) 38 245 034, E-mail: Info@kpm-ks.org, www.kpm-ks.org

Komunës së Zveçanit pranë partisë politike GI.SDP. në zgjedhjet lokale të mbajtura në nëntor të vitit 2013. Gjithashtu Pala Përgjegjëse e ka dhënë edhe betimin si anëtar i Kuvendit të Komunës Zveçanit si dhe vazhdon të jetë pjesë e Kuvendit Komunal të Zveçanit.

7. KPM, bazuar në shkeljet e vazhdueshme të Ligjit të KPM-së dhe Rregullores KPM-2013/04, nga ana e Palës Përgjegjëse, sërish me datën 4 korrik 2014 përmes një Urdhëri ka kërkuar nga Pala Përgjegjëse të veprojë në pajtueshmëri me nenin 22, paragrafi 3.1, të Ligjit të KPM-së dhe nenit 9, paragrafi 1.2, të Rregullores së KPM-së KPM-2013/04.
8. Pala Përgjegjëse edhe përkundër urdhërave të dërguara nga ana e KPM-së vazhdon të mbetet pronar i Radio Kosovska Mitrovica, duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 22, paragrafi 3.1, të Ligjit të KPM-së dhe nenit 9, paragrafi 1.2, të Rregullores KPM-2013/04.

Analiza Ligjore

9. Komisioni, bazuar në faktet e lartpërmendura konkludon se Pala Përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim me nenin 9, paragrafi 1.2, të Rregullores KPM 2013/04, dhe me nenin 22, paragrafi 3.1, të Ligjit të KPM-së i cili përcakton se licenca e transmetimit nuk i lëshohet ose nuk do të vazhdoj t'i jepet:

"partisë politike, bashkësisë fetare, grupit ose organizatës e cila menaxhohet nga individi cili mban post të zgjedhur ose është anëtar i një organi ekzekutiv të një partie politike."

10. Komisioni, duke u bazuar në faktet e lartpërmendura gjen se Pala Përgjegjëse ka dështuar të veprojë në pajtueshmëri me nenin 22, paragrafi 3.1, të Ligjit të KPM-së, pasi që Pala Përgjegjëse është përfshirë në aktivitetet politik dhe është zgjedhur anëtar i Kuvendit Komunal të Komunës së Zveçanit.
11. Komisioni, duke u bazuar në faktet e lartpërmendura, gjen se Pala Përgjegjëse ka vepruar edhe në kundërshtim me nenin 9, paragrafi 1.2, të Rregullores KPM-2013/04 i cili gjithashtu parasheh se licenca nuk i lëshohet dhe nuk mund t'i jepet:

"partisë politike, bashkësisë fetare, grupit ose organizatës e cila menaxhohet nga individi i cili mban post të zgjedhur ose është anëtar i një organi ekzekutiv të një partie politike".

12. Duke u bazuar në të gjitha faktet dhe analizat e lartpërmendura, Komisioni vlerëson se Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 22, paragrafi 3.1, të Ligjit të KPM-së dhe nenit 9, paragrafi 1.2, të Rregullores KPM- 2013/04.

Vendimi

13. Komisioni, bazuar në të gjitha faktet dhe analizat e lartpërmendura konstaton se Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 22, paragrafi 1, të Ligjit të KPM-së dhe nenit 9, paragrafi 1.2, të Rregullores KPM- 2013/04.
14. Pala Përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim me nenin 22, paragrafi 3.1, të Ligjit të KPM-së dhe nenin 9, paragrafi 1.2 të Rregullores KPM- 2013/04, pasi që vazhdon të mbetet pronar i


Komisioni i Pavarur i Mediave/Nezavisna Komisija za Medije/Independent Media Commission, Rr.Ul.Str. Perandori Justinian Nr. 14 Qyteza, Pejton, 10000 Prishtinë-Priştin- Pristina/Kosovë-Kosovo, Tel: (+381) (0) 38 245 031, Fax: (+381) (0) 38 245 034, E-mail: Info@kpm-ks.org, www.kpm-ks.org

subjektit transmetues Radio Kosovska Mitrovica, edhe përkundër faktit se ushtron funksionin e anëtarit në Kuvendin Komunal të Komunës së Zvecanit.

15. Komisionit në bazë të nenit 30, paragrafi 1.6, vendos që Pala Përgjegjëse të sanksionohet me ndërprerje të licencës së transmetimit për shkelje të nenit 22, paragrafi 3.1, të Ligjit të KPM-së dhe nenit 9, paragrafi 1.2, të Rregullores KPM-2013/04.

E drejta për Ankesë

16. Ankesat i parashtrihen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkohen nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.
17. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërisht relevante të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.



Adnan MEROVCI
Kryetar
Komisioni i Pavarur i Mediave



16.09.2014
datë